

UDHËZIM
Nr.3, datë 23.3.2005

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ZONËS ZGJEDHORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 31 pika 1 germa b, nenit 34 e vijues të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimit të KQZ-së nr.3, datë 26.1.2005 “Për caktimin e partive politike që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të KZZ-ve”,

UDHËZON:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të KZZ- së, të drejtat dhe detyrimet e saj dhe të anëtarëve, caktimin e rregullave për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjeve, marrjen e vendimeve, si dhe marrëdhëniet e KZZ-së me të tretët.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. Komisioni i Zonës Zgjedhore është organ kolegjal. Ai përgjigjet për administrimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në zonën përkatëse. Të drejtat dhe detyrat e KZZ-së përcaktohen në Kodin Zgjedhor dhe në aktet nënligjore të KQZ-së.

2. KZZ-ja ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me ligjin, në mënyrë të paanshme, profesionale dhe transparente.

PJESA II
PËRBËRJA E KZZ-SË

Neni 3
Ngritja e KZZ-së

1. KZZ-ja përbëhet nga shtatë anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen sipas procedurës së parashikuar në nenin 34, pika 1, germa a, b, c të Kodit Zgjedhor.

2. Anëtarët e KZZ-së për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2005, propozohen nga partitë politike si më poshtë:

- 1 anëtar nga Partia Socialiste e Shqipërisë;
- 1 anëtar nga Partia Demokratike e Shqipërisë;
- 1 anëtar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë;
- 1 anëtar nga Partia Demokrate e Re;
- 1 anëtar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut;
- 1 anëtar nga Partia Republikane Shqiptare;
- Anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZZ-ve nga Partia Socialiste e Shqipërisë, ndërsa në gjysmën tjetër nga Partia Demokratike, në varësi të shortit të hedhur në KQZ.

3. Sekretari i KZZ-së propozohet nga partia politike, e cila ka të drejtë të paraqesë propozimin për zëvendëskryetarin e KZZ-së.

Neni 4

Paraqitja e propozimeve nga partitë politike

1. KQZ u dërgon njoftim partive politike, që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të KZZ-së.

2. Propozimi përmban emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, vendbanimin dhe arsimin e personit që propozohet për t'u emëruar si anëtar i KZZ-së.

3. Së bashku me të dhënat e mësipërme, propozimi shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Certifikatë lindjeje me fotografi;
- Dëshmi e arsimit të lartë;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore.

4. KQZ-ja ruan dhe administron të dhënat për komisionerët zgjedhorë, si dhe çdo të dhënë tjetër që lidhet me ushtrimin e funksionit nga ana e tyre.

Neni 5

Emërimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZZ-së

KQZ-ja emëron me vendim anëtarët dhe sekretarin e KZZ-së, sipas propozimeve të partive politike.

Shkarkimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZZ-së

Neni 6

1. Anëtari dhe sekretari i KZZ-së shkarkohen nga detyra sipas përcaktimeve të nenit 35 pika 1.

2. Shkarkimi bëhet me vendim të KQZ-së.

3. Propozimi për shkarkimin e anëtarit apo të sekretarit të KZZ-së mund të bëhet nga çdo subjekt zgjedhor.

4. KQZ merr vendim për lirim kur votojnë pro shumica e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Neni 7

Anëtari dhe sekretari i KZZ-së i shkarkuar me vendim të KQZ-së, nuk mund të rizgjidhet në këtë detyrë.

Lirimi nga detyra i anëtarit apo sekretarit të KZZ-së

Neni 8

1. Anëtari ose sekretari i KZZ-së lirohet nga detyra kur subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 2 të nenit 35, propozimi për lirim nga detyra të anëtarit ose sekretarit të KZZ-së mund të paraqitet nga çdo subjekt zgjedhor.

Neni 9

Plotësimi i vendit vakant

1. Kur vendi i një anëtari të KZZ-së mbetet vakant, KQZ-ja i kërkon partisë politike përkatëse të paraqesë propozimin për anëtarin e ri. Emërimi i anëtarit të ri bëhet sipas afateve të përcaktuara në nenin 34 pika 8 të Kodit Zgjedhor.

2. Kur anëtari i KZZ-së jep dorëheqjen, deklarata e dorëheqjes depozitohet në KZZ. Sekretari bën shënimet përkatëse në librin e protokollit të KZZ-së. Menjëherë pas shënimit, sekretari përgatit dhe i dërgon njoftimin KQZ-së lidhur me krijimin e vakancës. Sekretari i bashkëngjit detyrimisht njoftimit një kopje të deklaratës së dorëheqjes.

PJESA III
EMËRIMI I KRYETARIT DHE I ZËVENDËSKRYETARIT TË KZZ-SË

Neni 10

Propozimi i Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të KZZ-së

1. KZZ-ja merr vendim për propozimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KZZ-së.
2. Në KZZ-të, ku anëtari i shtatë emërohet me propozim të Partisë Socialiste të Shqipërisë, njëri prej dy anëtarëve të emëruar me propozim të PSSH-së, i propozohet KQZ-së për ta emëruar kryetar të KZZ-së. Në këto raste vetëm anëtari i emëruar me propozim të PD, i propozohet KQZ-së për ta emëruar zëvendëskryetar të KZZ-së.
3. Në KZZ-të, ku anëtari i shtatë emërohet me propozim të Partisë Demokratike, njëri prej dy anëtarëve të emëruar me propozim të PD-së, i propozohet KQZ-së për ta emëruar kryetar të KZZ-së. Në këto raste vetëm anëtari i emëruar me propozim të PSSH, i propozohet KQZ-së për ta emëruar zëvendëskryetar të KZZ-së.
4. Për propozimin e kryetarit, çdo anëtar i KZZ-së duhet detyrimisht të votojë pro njërit prej dy anëtarëve të emëruar me propozim, sipas rastit, të PSSH apo të PD.
5. Anëtarët e KZZ-së janë të detyruar të votojnë pro emërimit të zëvendëskryetarit të KZZ-së.
6. Vendimet e KZZ-së i dërgohen menjëherë KQZ-së.

PJESA IV
TË DREJTAT DHE DETYRAT E ANËTARIT TË KZZ-SË

Neni 11

Të drejtat e anëtarit të KZZ-së

1. Anëtari i KZZ-së ka të drejtën e shpërblimit për punën e bërë. Masa e shpërblimit në vit zgjedhor dhe jozgjedhor përcaktohet me vendim të KQZ-së.
2. Gjatë kohës që anëtari i KZZ-së ushtron këtë detyrë, nuk humbet të drejtat dhe detyrat në vendin e tij të punës.
3. Në rastet kur anëtari i KZZ-së ndalohet ose arrestohet gjatë periudhës zgjedhore, organi kompetent dhe vetë KZZ-ja njofton menjëherë KQZ-në.
4. Çdo anëtar i KZZ-së ka të drejtë të komunikojë dhe informojë KQZ-në për çdo problem që ai e sheh të arsyeshme.

Neni 12

Detyrat e anëtarit të KZZ-së

1. Anëtari i KZZ-së është i detyruar të zbatojë Kushtetutën, Kodin Zgjedhor, vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së, si dhe vendimarrjen në KZZ.
2. Anëtari i KZZ-së është i detyruar të paraqitet rregullisht në detyrë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim dhe akte të tjera të KQZ-së.
3. Në ushtrimin e funksionit të tij, anëtari i KZZ-së duhet të respektojë rregullat e etikës.

PJESA V
TË DREJTAT DHE DETYRAT E SEKRETARIT TË KZZ-SË

Neni 13

1. Sekretari i KZZ-së ka këto të drejta:
 - a) merr pjesë në mbledhjet e KZZ-së si anëtar pa të drejtë vote;
 - b) diskuton dhe jep mendimin e tij në mbledhjet e KZZ-së, për çështje që shqyrtohen, sa herë

shihet e arsyeshme nga komisioni;

c) të drejta të tjera që burojnë nga Kodi Zgjedhor.

2. Sekretari i KZZ-së kryen këto detyra:

a) administron dhe ruan të gjithë dokumentacionin e KZZ-së, si dhe është përgjegjës për përdorimin e vulës;

b) protokollon kërkesat, ankesat dhe njoftimet drejtuar KZZ-së;

c) jep asistencë juridike për KZZ-në;

ç) përgatit materialet e mbledhjes dhe ua shpërndan ato anëtarëve të KZZ-së;

d) mban procesverbalet e mbledhjeve të KZZ-së. Në fillim të çdo mbledhjeje evidenton prezencën e anëtarëve të KZZ-së;

dh) regjistron vendimet e KZZ-së në regjistrin përkatës dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara;

e) brenda 12 orëve nga miratimi i vendimit, sekretari përpilon aktin zyrtar në përputhje me modelet e miratuara nga KQZ-ja;

ë) u jep subjekteve zgjedhore ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve të KZZ-së ose procesverbaleve të mbledhjeve të tyre;

f) regjistron në protokoll marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KQZ-ja, sipas nenit 93 të Kodit Zgjedhor dhe përgjigjet për administrimin dhe ruajtjen e tyre, në përputhje me kërkesat e këtij Kodi;

g) me kërkesë të zgjedhësve, lëshon vërtetime nëse emri i zgjedhësit gjendet ose jo në listat përfundimtare të zgjedhësve në zonën zgjedhore përkatëse;

gj) kryen detyra të tjera që burojnë nga Kodi Zgjedhor dhe akte nënligjore të KQZ-së;

h) regjistron në librin e protokollit vërejtjet që vëzhguesit i paraqesin komisionit.

PJESA VI

PËRFAQËSUESIT E SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

Neni 14

Përfaqësuesi i kandidatit

1. Çdo kandidat për deputet në zonën zgjedhore njëemërore i paraqet KZZ-së, sëbashku me dokumentet e kandidimit, emrin e personit, i cili do të jetë përfaqësuesi i tij zyrtar në KZZ.

2. Sekretari i KZZ-së pajis përfaqësuesin e kandidatit me dokument identifikues, sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja, si dhe e njeh me të drejtat dhe detyrat e tij.

Neni 15

Të drejtat e përfaqësuesit të kandidatit

Përfaqësuesi i kandidatit ka të drejtë:

1. Të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e KZZ-së;

2. Paraqet propozime e kërkesa për çështje, të cilat shqyrtohen në rendin e ditës;

3. Në përfundim të mbledhjes së KZZ-së, përfaqësuesi i kandidatit ka të drejtë të paraqesë propozime për çështje të ndryshme, që nuk kanë qenë në rendin e ditës;

4. Të marrë kopje të vendimeve dhe akteve të tjera të KZZ-së, pas zbardhjes së tyre;

5. Të kërkojë informacion për të gjitha aspektet e veprimtarisë së KZZ-së dhe t'i vëzhgojë ato pa penguar zhvillimin normal të veprimtarisë së saj;

6. Të ndjekë programet trajnuese të KZZ-së.

Neni 16

Detyrat e përfaqësuesit të kandidatit

Përfaqësuesi i kandidatit ka detyrë:

1. Të respektojë dispozitat e këtij udhëzimi, si dhe akte të tjera që lidhen me organizimin dhe funksionimin e KZZ-së;

2. Të zbatojë rregullat e etikës në KZZ;
3. Të mbajë në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit, të lëshuar nga KZZ-ja;
4. Të mos mbajë shenja dalluese që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit.

Neni 17
Vëzhguesit

E drejta për të caktuar vëzhgues, rregullat për paraqitjen e kërkesave, akreditimin e vëzhguesve, si dhe të drejtat e detyrat e vëzhguesve rregullohen me akt të veçantë të KQZ-së.

PJESA VII
DETYRAT DHE FUNKSIONIMI I KZZ-SË

Neni 18
Detyrat e KZZ-së

Në përputhje me detyrat e përcaktuara në nenin 36 të Kodit Zgjedhor, KZZ-ja ushtron këto kompetenca:

1. Njofton anëtarët e KQV-ve për programet e trajnimit të organizuar nga KQZ-ja, merr masa për mbarëvajtjen e tyre, si dhe evidenton pjesëmarrjen;
2. Mban kontakte të vazhdueshme me KQZ-në dhe me organet e qeverisjes vendore;
3. Bashkëpunon me organet e qeverisjes vendore, për sigurimin e ambienteve dhe bazës së nevojshme logjistike, për funksionimin e KZZ-së dhe KQV-ve;
4. Dërgon informacion të vazhdueshëm në KQZ, mbi aktivitetin e KZZ-së;
5. Afishon në vende publike të dhëna që lidhen me zhvillimin e zgjedhjeve në zonën zgjedhore;
6. Shqyrton dhe merr vendim për të gjitha kërkesat dhe ankesat e paraqitura nga subjektet zgjedhore;
7. Mbikëqyr dhe asiston përgatitjen e mjediseve të qendrave të votimit, merr masa për përshtatjen e mjediseve të qendrave të votimit, për të lehtësuar votimin e personave me aftësi të kufizuara;
8. Verifikon dhe mbikëqyr masat, që janë marrë për sigurimin dhe ruajtjen e materialeve zgjedhore deri në fillimin e procesit të votimit.

Neni 19
Zyra e KZZ-së

1. Në caktimin e vendndodhjes së zyrës së KZZ-së mbahen parasysh edhe:
 - a) numri i zgjedhësve të njësisë vendore;
 - b) zona urbane;
 - c) qyteti qendër prefekturë;
 - d) qyteti qendër nënprefekturë;
 - e) gjendja e rrugëve, lidhjes telefonike dhe ndërtesave publike;
 - f) pozicioni gjeografik i zonës zgjedhore etj.
2. Zyra e KZZ-së duhet të jetë me sipërfaqe të mjaftueshme për të siguruar zhvillimin normal të veprimtarisë së Komisionit.
3. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, në të cilën do të ketë zyrën KZZ-ja, duhet të sigurojë në kohë ambientin dhe pajisjet përkatëse.
4. Në zyrën e KZZ-së, në një vend të dukshëm, duhet të vendoset flamuri kombëtar.
5. Në hyrjen kryesore, për në zyrën e KZZ-së, duhet të vendoset tabela treguese e KZZ-së, si dhe të jenë afishuar emrat e anëtarëve të KZZ-së, numri i telefonit të zyrës dhe orari i punës.
6. Zyra e KZZ-së është e pajisur me linjë telefonike të rrjetit fiks.

Neni 20

Dokumenti i identifikimit

1. Gjatë ushtrimit të detyrës, anëtarët dhe sekretari i KZZ-së janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentet e identifikimit sipas modelit të miratuar nga KQZ.

2. Përfaqësuesit e kandidatëve të partive politike dhe vëzhguesit janë të detyruar që, gjatë qëndrimit në mjediset e KZZ-së, të mbajnë dokumentin përkatës të identifikimit.

Neni 21

Vula e KZZ-së dhe përdorimi

1. KZZ-ja përdor vulën e dërguar nga KQZ-ja.

2. Vula e KZZ-së mbahet nga sekretari, i cili e administron atë në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe aktet e tjera të KQZ-së.

3. Vula e KZZ-së vendoset në të gjitha aktet e nxjerra dhe të miratuara nga KZZ-ja.

4. Në mungesë të Sekretarit gjatë vendimmarrjes së KZZ-së, vula përdoret nga zëvendëskryetari i KZZ-së.

5. Vula nuk mund të nxirret për asnjë arsye jashtë ambienteve të punës së KZZ-së.

6. Në rast se vula e KZZ-së bëhet e papërdorshme, KZZ-ja mban një procesverbal në të cilin pasqyron rrethanat e pamundësisë së përdorimit të vulës dhe ia bën këtë me dije KQZ-së. KQZ-ja vlerëson informacionin e paraqitur dhe realizon procedurat e nevojshme për pajisjen e KZZ-së me vulën e re.

7. Në rast se vula e KZZ-së humbet, KZZ-ja mban procesverbal në të cilin pasqyron faktin, si dhe lajmëron organet e policisë. KZZ i dërgon KQZ-së kopje të procesverbalit të mbajtur dhe njoftimit për organet e policisë.

Neni 22

Koha e punës së KZZ-SË

1. Në periudhën jozgjedhore KZZ-ja qëndron në detyrë nga ora 11.⁰⁰ deri 13.⁰⁰ dhe nga ora 17.⁰⁰ deri 20.⁰⁰.

2. Gjatë periudhës zgjedhore dhe deri tre ditë para datës së zgjedhjeve, KZZ-ja punon paradite nga ora 08.⁰⁰ deri 13.⁰⁰ dhe mbasdite 16.⁰⁰ deri 20.⁰⁰.

3. Tre ditë para datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar dhe dorëzimin në KQZ të dokumentacionit zgjedhor përkatës, KZZ-ja është e detyruar të qëndrojë në mënyrë permanente e mbledhur në zyrë.

4. Sekretari i KZZ-së shënon në procesverbal kohën e largimit dhe kthimit të çdo anëtari në komision.

PJESA VIII

MBLEDHJET E KZZ

Neni 23

Njoftimi për mbledhjet e KZZ-së

1. Mbledhja e parë e KZZ-së thirret me vendim të KQZ-së.

2. Vendimi për mbledhjen e KZZ-së bëhet publik.

3. Vendimi u dërgohet partive politike, të cilat kanë propozuar anëtarët e KZZ-së dhe përmban: datën, vendin dhe orën e mbledhjes së parë të KZZ-së.

4. Në përputhje me vendimin e KQZ-së, sekretari i KZZ-së merr masa për njoftimin e anëtarëve dhe përgatitjen e mbledhjes.

Neni 24

1. Mbledhja e parë e KZZ-së drejtohet nga anëtari më i vjetër.
2. Në këtë mbledhje, KZZ-ja merr vendim për propozimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KZZ-së, sipas modeleve të miratuara nga KQZ-ja.

Procedura e zhvillimit të mbledhjeve të KZZ-së

Neni 25

1. Mbledhjet e KZZ-së janë publike. Ato zhvillohen vetëm në ambientet e saj të punës.
2. Mbledhjet e KZZ-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të KZZ-së.
3. Mbledhjet e KZZ-së në vijimësi thirren nga kryetari, zëvendëskryetari ose së paku nga dy anëtarë të saj. Sekretari është përgjegjës për njoftimin e anëtarëve.
4. Sekretari është përgjegjës për përgatitjen e materialeve të mbledhjes.

Neni 26

1. Mbledhja e KZZ-së drejtohet nga kryetari dhe në mungesë të tij nga zëvendëskryetari.
2. Drejtuesi i mbledhjes paraqet çështjen që është për shqyrtim dhe i jep fjalën anëtarëve për të diskutuar.
3. Çdo anëtar i KZZ-së diskuton dhe paraqet propozime për çështje që janë në rendin e ditës.
4. Në mbledhje u jepet fjala për të bërë pyetje apo diskutime edhe përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore.
5. Pasqyrimi i mbledhjeve të KZZ-së, bëhet në librin e protokollit të mbledhjeve, i cili duhet të përmbajë të paktën:
 - datën, vendin dhe orën e mbledhjes;
 - anëtarët që morën pjesë;
 - çështjet që u diskutuan;
 - përmbajtjen e diskutimeve;
 - forma dhe rezultati i votimit të anëtarëve të KZZ-së;
 - vendimet që u morën.
6. Në mbledhjen e KZZ-së pjesëmarrësve u ndalohej çdo lloj komunikimi me telefon ose forma të tjera me të tretët.
7. Në përfundim të mbledhjes procesverbali përkatës në librin e protokollit të mbledhjeve firmoset në çdo faqe nga sekretari. Anëtarët e KZZ-së, nëse dëshirojnë, kanë të drejtë të nënshkruajnë procesverbalin si më sipër.

PJESA IX VENDIMMARRJA

Neni 27

Mbyllja e diskutimeve dhe votimi i propozimeve

1. Në përfundim të diskutimeve, drejtuesi i mbledhjes paraqet me radhë propozimet dhe fton anëtarët e KZZ-së për të votuar për secilin propozim.

Neni 28

Procedura e votimit dhe firmosja e vendimeve

1. Vendimet në KZZ merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KZZ-së. Sekretari nuk ka të drejtë vote.
2. Vendimet e KZZ-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim, si dhe vulosen me vulën e KZZ - së nga sekretari.
3. Secili prej anëtarëve të KZZ-së krahas nënshkrimit të tij në vendim shënon votën “pro” ose “kundër”.

4. Vendimet e KZZ-së shoqërohen me mendimin e pakicës nëse ka të tillë.
5. Sekretari i KZZ-së shënon në librin e protokollit të mbledhjeve rezultatet e votimit për çdo propozim.
6. KZZ-ja është e detyruar që të bëjë menjëherë publike, vendimet e marra dhe të dërgojë në KQZ një kopje të këtyre vendimeve.

PJESA X DOKUMENTACIONI I KZZ

Neni 29

1. Sekretari i KZZ-së është përgjegjës për mbajtjen në arkiv dhe sistemimin e dokumentacionit zgjedhor të KZZ-së. Sekretari i KZZ-së krijon dosje të veçanta në lidhje me vendimet dhe udhëzimet e dërguara nga KQZ-ja, në lidhje me aktet e nxjerra prej saj, me kërkesat, ankesat apo pretendimet e subjekteve zgjedhore, me emërimin e anëtarëve të KQV-ve, caktimin e anëtarëve të grupeve të numërimit të votave etj.
2. Me kërkesë të subjekteve zgjedhore, sekretari i KZZ-së jep kopje të akteve.
3. “Regjistri i korrespondencës së KZZ-së”, sipas modelit tip të përgatitur nga KQZ-ja, mbahet nga sekretari i KZZ-së dhe shërben për regjistrimin e akteve të ndryshme që hyjnë dhe dalin nga institucioni i KZZ-së.
4. “Regjistri i vendimeve të KZZ-së”, sipas modelit tip të përgatitur nga KQZ-ja, mbahet nga sekretari i KZZ-së dhe shërben për regjistrimin e të gjitha vendimeve që merren nga KZZ-ja.

Neni 30

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.